

V E N D I M
Nr. 514, datë 24.10.2002

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNITIT NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKS TË GREQISË PËR
PROGRAMIN PESËVJEÇAR TË ZHVILLIMIT 2002-2006**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Greqisë për programin pesëvjeçar të zhvillimit 2002-2006.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË TË REPUBLIKËS
TË GREQISË MBI PROGRAMIN E BASHKËPUNITIT PESËVJEÇAR PËR ZHVILLIM
2002-2006

Qeveria e Republikës së Greqisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë më poshtë referohen si "Palët":

Duke marrë në konsideratë udhëzuesin e Komisionit të Asistencës së Zhvillimit të OECD-së;

Duke kujtuar marrëdhëniet e përbashkëta midis BE-së dhe shteteve të rajonit, si dhe marrëveshjeve ekzistuese në këtë kuadër;

Duke riafirmuar përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar në këtë zonë;

Duke mbajtur në konsideratë se Republika Greke ka formuluar dhe është gati të zbatojë një plan 5-vjeçar për zhvillim, i cili së bashku me organizatat ndërkombëtare, institucionet financiare dhe donatorë të tjerë dypalësh ka për qëllim rikonstruksionin dhe tranzicionin e vendeve pritëse të Ballkanit kundrejt qëllimeve të zhvillimit për të cilat është rënë dakord;

Duke përsëritur rëndësinë e arritjeve të zhvillimit rajonal, që kanë për qëllim kontributin për paqe, siguri, prosperitet dhe stabilitet në rajon;

Duke pasur parasysh që Republika e Greqisë dhe Republika e Shqipërisë kanë dëshirë të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale të forta bazuar në partneritet dhe transparencë, shoqëruar me një program asistence për zhvillim, në mënyrë që qëllimet e programit aktual të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe orientimin për në Europë të Republikës së Shqipërisë;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimet

Sektorët kryesorë të programit të asistencës për zhvillim janë si më poshtë:

- a) modernizimi i infrastrukturës, veçanërisht në energji dhe në sektorin e transportit;
- b) promovimi i investimeve në sektorë prodhues;
- c) modernizimi i administratës publike dhe vetëqeverisjes;
- d) mbështetja e institucioneve demokratike bashkëpunimi me parlamentin;
- e) mbështetja për mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës dhe rritjen e mirëqenies;
- f) zbutjen e pabarazive ekonomike;

g) mbështetja për arsimin dhe trajnimin profesional në nivelin e potencialeve administrative dhe shkencore.

Të gjitha projektet, me përjashtim të atyre të përcaktuara në nenin A2, paragrafi 2 të aneksit A, që kanë lidhje me fushat e lartpërmendura do të shtohen në aneksin B të kësaj Marrëveshjeje me aprovimin e Palës Greke. Aneksi B është pjesa përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Alokimi i fondeve për zhvillim

(a) Asistenca e zhvillimit nga Republika Greke për Republikën e Shqipërisë, dhënë nëpërmjet marrëveshjes, arrin shumën prej dyzet e nëntë milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë euro (49,890,000 euro) për një periudhë kohe pesëvjeçare (2002-2006). Shuma e mësipërme do të alokohet në formën e grantit në baza vjetore, në përputhje me programin kuadër të bashkëpunimit dypalësh.

(b) Njëzet për qind (20%) e shumës totale do të alokohet nga Ministria Greke e Ekonomisë dhe e Financës për investime private në sektorin prodhues në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

(c) Një nga qëllimet kryesore të asistencës dypalëshe për procesin e rikonstruksionit ekonomik, social dhe institucional në Republikën e Shqipërisë është të jetë komplementare me programet e zhvillimit të Bashkimit Europian, institucioneve financiare ndërkombëtare, si dhe donatorëve dypalëshe. Gjithashtu, do të merret në konsideratë dhe impakti rajonal i asistencës për zhvillim.

Neni 3

Procedurat e vlerësimit dhe të monitorimit

Të dyja Palët janë dakord mbi procedurat e vlerësimit dhe monitorimit për programin e mësipërm të asistencës për zhvillim.

Në këtë kontekst, përgjegjësia për monitorimin dhe vlerësimin e asistencës për zhvillim në palën pritëse i besohet koordinatorit kombëtar për zbatimin e planit grek për rindërtimin ekonomik të ballkanit, i cili prej këtu e më poshtë do të quhet HIPERB.

Modalitetet përcaktohen në aneksin A, i cili është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Komiteti i Përbashkët i Menaxhimit

Për menaxhimin dhe zbatimin e programit të asistencës për zhvillim do të formohet një komitet menaxhues i përbashkët.

Modalitetet që kanë të bëjnë me formimin, kompetencat dhe funksionimin e Komitetit të Përbashkët të Menaxhimit përcaktohen në aneksin (A) të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Pajtueshmëria me politikat e Komitetit Europian

Në aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, Republika Greke do të respektojë detyrimet e saj si anëtare e Bashkimit Europian.

Projektet dhe aktivitetet e financuara të programit të asistencës për zhvillim do të pajtohen me politikat e Komunitetit Europian, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit, transportin, rrjetin transeuropian (TREN), konkurrencën, si dhe prokurimet publike.

Komiteti Monitorues i HiPERB-it do të sigurojë koordinimin dhe koherencën midis projekteve të financuara të këtij Programi.

Neni 6

Bashkërendimi dhe koherenca me donatorët e tjerë

Të dyja Palët janë dakord për mundësinë e pjesëmarrjes së vendeve të tjera ose organizatave

ndërkombëtare dhe insitucioneve të bashkëpunimit rajonal në mbështetjen financiare për zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve të këtij Programi.

Bashkëfinancimet do të përdoren për pjesë të identifikueshme qartë të projekteve. Shuma e mbështetjes financiare të HiPERB-it dhe burimeve të tjera financuese nuk duhet të kalojë 90% të kostos së Projektit.

Neni 7

Pengesat dhe rrethanat e jashtëzakonshme

Në rastin e pengesave të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me rrethanat e jashtëzakonshme të njohura nga të dyja Palët (siç janë lufta, fatkeqësitë natyrore, trazirat civile) ose në rast rreziku do të zbatohen kushtet e mëposhtme:

(a) Në rast se bllokimi i shpenzimeve të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje zgjat më pak se (24) muaj, përdorimi i fondeve për zbatimin e aktivitetit do të bllokohet. Këto fonde do të vihen përsëri në përdorim pasi shkaku i bllokimit të jetë eliminuar.

(b) Në rast se bllokimi i shpenzimeve të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje zgjat më shumë se njëzet e katër (24) muaj, Palët duhet të diskutojnë për vazhdimësinë e kësaj Marrëveshjeje. Fondet e ngelura do të përdoren vetëm nëse bihet dakord midis dy Palëve.

Pavarësisht nga më sipër, Palët, në rast vështirësie për realizimin e objektivave të përcaktuara me këtë asistencë, ose për plotësimin e qëllimeve të ndërmarra me këtë Marrëveshje, duhet të bëjnë çdo përpjekje të nevojshme për mirëpërdorimin e kësaj asistence.

Neni 8

Denoncimi ose pezullimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të denoncohet ose pezullohet pas njoftimit bërë Palës tjetër. Denoncimi bëhet efektiv në rrethanat e mëposhtme specifike:

(a) në rastin kur njëra prej Palëve shkel termat dhe kushtet e Marrëveshjes, veçanërisht në rastet e zgjatjeve dhe vonesave të pajustificuara në përfundimin e aktiviteteve të parashikuara me këtë Marrëveshje, ashtu si dhe në menaxhimin jo të mirë të fondeve;

(b) në rastet e zhvillimit të ngjarjeve, të cilat dëmtojnë realizimin e qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet të cilat kanë të bëjnë me zbatimin dhe/ose respektimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Neni 10

Amendamentet

Palët mund të bëjnë shtesa në këtë Marrëveshje nëpërmjet shkëmbimit të notave. Këto shtesa do të hyjnë në fuqi sipas procedurave të vendosura në këtë Marrëveshje në nenin 11.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me marrjen e njoftimit të fundit me shkrim, i cili konfirmon plotësimin e të gjitha procedurave të brendshme përkatëse për të dyja Palët.

Në prani të të dyja Palëve, nënshkruesit të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse kanë firmosur këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, në 26 gusht 2002, në 2(dy) kopje origjinale të shkruajtura në anglisht, me të dy tekstet të barazvlefshme.

Për Qeverinë e Republikës së Greqisë
Zv/Ministri i Punëve të Jashtme
Andreas Loverdos

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Ministri i Ekonomisë
Arben Malaj

ANEKSI A

Neni 1 A

1. Në kuadër të punës së HiPERB-it, Qeveritë e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë bien dakord për Programin e Bashkëpunimit Ekonomik Bilateral për Republikën e Shqipërisë (këtu e më poshtë të quajtur Shqipëria) për periudhën 2002-2006, duke u mbështetur në prioritetet e përcaktuara ndërmjet të dy Palëve. Programi do të mbështetet sipas një rendi prioritetesh, objektivat afatgjata në sektorët që kërkojnë ndërhyrje. Programi do të vlerësohet nga Komiteti i Monitorimit të HiPERB-it, do të miratohet nga Ministri i Punëve të Jashtme i Greqisë dhe mund të rishikohet nëse do të paraqitet nevoja.

2. Në bazë të Marrëveshjes së mësipërme për bashkëpunimin pesëvjeçar për zhvillim, do të miratohet një program vjetor veprimi. Në këtë program vjetor do të përcaktohen qartë objektivat, sektorët e ndërhyrjes dhe buxheti. Këto programe do të përfshijnë listën e projekteve ose të aktiviteteve që do të financohen, si dhe kostot e tyre.

3. Marrëveshja e mësipërme për bashkëpunimin pesëvjeçar, në përputhje me klasifikimin vertikal të asistencës dypalëshe për zhvillim (sipas sektorëve dhe destinacionit), do të ofrojë grante në sektorët e mëposhtëm, me kusht që të jenë në përputhje me objektivat e HiPERB-it:

- infrastrukturë sociale dhe shërbime sociale: aktiviteteve për rritjen e standardeve të nivelit të jetesës dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në Shqipëri;
- infrastruktura ekonomike dhe shërbimet: aktivitete në zhvillimin e networkut, infrastrukturës dhe shërbimeve sociale, që forcojnë dhe rrisin aktivitetin ekonomik;
- sektorët e prodhimit: aktivitete që kontribuojnë në të gjithë sektorët e prodhimit;
- projekte horizontale: programi do të mbulojë më shumë se një sektor.

Neni 2 A

Burimet financiare

1. Për periudhë 2002-2006 buxheti total për Shqipërinë është 49.89 milion euro me çmimet e vitit 2002.

2. Njëzet për qind (20%) e burimeve të programit do të vihet në dispozicion të investimeve private në sektorë prodhues. Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Greqisë, mbi bazën e aplikimeve nga firma private, do të vendosë mbi përfshirjen dhe financimin e investimeve private sipas procedurave të përcaktuara nga legjislacioni grek. Gjithë aplikimet do të jenë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe rregullat për zbatim të projekteve të propozuara. Koordinator kombëtar, me kërkesën e Ministrit të Ekonomisë dhe të Financave të Greqisë, do të garantojë që aplikimet për financim projektësh të jenë në përputhje me objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

3. Një për qind e fondit do të vihet në dispozicion të Ambasadës së Republikës të Greqisë në Tiranë, që do të financojë projekte të vogla. Ky fond mund të financojë edhe projekte të vogla teknike me natyrë emergjente dhe me impakt të drejtpërdrejtë me shoqërinë lokale, me kosto jo më të madhe se 50 000 euro. Alokimi i fondeve do të miratohet nga kreu i Ambasadës së Republikës të Greqisë në Tiranë në konsultim me koordinatorin kombëtar. Kreu i Ambasadës së Greqisë do të ketë përgjegjësinë për vlerësimin e prioriteteve dhe monitorimit të zbatimit të projekteve, si dhe të raportojë tek Komiteti monitorues i HiPERB-it në kuadër të raportit vjetor, siç përcaktohet në nenin A 11 të këtij dokumenti.

4. Me miratimin e të dy Palëve, mund të rishikohet alokimi i fondeve në mënyrë që të garantohet respektimi i objektivave të Marrëveshjes.

5. Kontributet e Qeverisë Greke, sipas kësaj Marrëveshjeje, në asnjë rrethanë nuk do të përdoren për të paguar taksa apo detyrime doganore për projekte që zbatohen në territorin e

Republikës së Shqipërisë. Nëse këto taksa, detyrime doganore ose për leje dhe autorizime do të kërkohej të paguhen, ato do të përballohen nga përfituesi i Projektit qoftë ai entitet publik, apo privat.

Regulla dhe procedura

Neni 3 A **Përkufizime**

Instrumentet për zbatimin e Marrëveshjes pesëvjeçare për bashkëpunimin për zhvillim do të jenë si më poshtë:

a) Komiteti i monitorimit të HiPERB-it: është instrumenti përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e HiPERB-it. Kryetari i tij është Sekretari i Përgjithshëm për Marrëdhëniet Ekonomike me Jashtë i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Greqisë. Anëtarë të këtij komiteti janë edhe Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive të mëposhtme të Greqisë: i Investimeve dhe Zhvillimit, i Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare, i Ministrisë së Punëve të Jashtme, i Ministrisë së Zhvillimit, i Ministrisë së Ambientit, i Ministrisë së Planifikimit Territorial dhe i Punëve Publike, i Ministrisë së Transporteve dhe i Ministrisë së Maqedoni-Trakisë.

b) Sekretariati i Komitetit të monitorimit të HiPERB-it (që këtu e më poshtë i quajtur Sekretariati): është mekanizmi mbështetës i Komitetit të monitorimit, i formuar nga zyrtarë të zyrës qendrore të MPJ-së dhe të zyrës rajonale të bashkëpunimit ndërkombëtar në MPJ-së në Selanik.

c) Koordinatori kombëtar i Marrëveshjes së bashkëpunimit pesëvjeçar të bashkëpunimit ekonomik (që këtu e më poshtë i quajtur koordinatori kombëtar): është Ministri i Ekonomisë i Qeverisë Shqiptare, i cili do të garantojë koordinimin e përgjithshëm dhe transparencën lidhur me përdorimin e fondeve të HiPERB-it dhe të përforimit të përshtatshëm të tyre.

d) Komiteti i Përbashkët i Menaxhimit: Komiteti i Përbashkët formohet siç bihet dakord ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë dhe që kryesohet nga përfaqësuesi i zyrës përgjegjëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë dhe të Koordinatorit Kombëtar të Republikës së Shqipërisë ose nga përfaqësuesi i tij. Në këtë komitet marrin gjithashtu pjesë edhe përfaqësues të autoriteteve kompetente të Shqipërisë (koordinatori kombëtar, Ministria Punëve Publike dhe/ose e ministrive të linjës, autoritete lokale dhe rajonale përgjegjëse për zbatimin e projekteve), përfaqësues të ministrive greke që do të marrin pjesë në Komitetin monitorues të HiPERB-it, si dhe specialistë të çdo vendi partner në Komitetin Monitorues të HiPERB-it. Komiteti i përbashkët i menaxhimit i raporton Komitetit të Monitorimit të HiPERB-it.

e) Llogaria e veçantë: do të jetë llogari me interes e përcaktuar në euro e hapur në Banka Komerciale me prezencë në Shqipëri, siç do të vendoset nga Pala Greke. Greqia i transferon burimet financiare të programit nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, pas kërkesës së paraqitur nga koordinatori kombëtar me treguesin " HiPERB-it - Programi pesëvjeçar i bashkëpunimit për zhvillim". Banka e Shqipërisë do të transferojë fondet në llogarinë e veçantë në Bankën Komerciale brenda pesë (5) ditëve pune.

Neni 4 A **Komiteti i Përbashkët i Menaxhimit**

Ky komitet siç është përcaktuar në nenin A3 paragrafi d i këtij dokumenti, do të jetë përgjegjës për aplikimin, menaxhimin dhe implementimin e programit dhe në mënyrë të veçantë për:

a) zbatimin dhe ecurinë ekonomike dhe fizike të projekteve sipas miratimit të dhënë për aktivitetet në bazë të marrëveshjes pesëvjeçare për bashkëpunimin për zhvillim, si dhe çështjeve teknike që kanë të bëjnë me Programin, si dhe dhënien e informacionit Komitetit monitorues të HiPERB-it;

b) shqyrtimin e raportit të ecurisë së programit dhe miratimin e raportit vjetor para se këto të paraqiten në Komitetin monitorues të HiPERB-it. Raporti vjetor do të përfshijë një aneks me informacion mbi investimet private të bëra në sektorë prodhues në Shqipëri sipas termave të kësaj Marrëveshje;

c) zbatimin e vendimeve dhe udhëzimeve të Komitetit monitorues të HiPERB-it;

d) paraqitjen e propozimeve në Komitetin monitorues të HiPERB-it lidhur me nevojën për marrjen e masave të duhura.

Neni 5 A

Aprovimi i projekteve - kriteri seleksionues i projekteve/aktiviteteve

1. Propozimet zyrtare të projekteve do të paraqiten nga koordinatori kombëtar në bazë të një "formular aplikimi" standard. Projektet duhet të kenë një shkallë ndikimi të rëndësishëm dhe domethënës në zonat me prioritet. Kostoja totale e projektit në parim nuk duhet të jetë më e vogël se 150 mijë euro. Vetëm në raste të jashtëzakonshme, kostoja totale e projektit mund të jetë më e vogël se 150 mijë euro.

2. Kërkesa zyrtare e projektit duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- agjensinë përgjegjëse për zbatimin e Projektit;
- natyrën e investimit dhe një përshkrim të detajuar;
- vlerësimin e koston dhe vendndodhjen e Projektit, duke përfshirë, atje ku është e mundur, një referencë të projekteve me interes të përbashkët;
- një plan pune të zbatimit të Projektit;
- në rastet kur është e mundur, një analizë kosto-përfitim, duke përfshirë efektet e drejtpërdrejta në punësim dhe një vlerësim të ndikimit mbi ambientin;
- informacionin mbi rregullat e kontratës publike;
- planin e financimit, duke përfshirë ku është e mundur treguesit e leverdisshmërisë ekonomike të Projektit;
- financimin total të kërkuar nga Republika e Shqipërisë mbi bazën e këtij Programi;
- informacionin mbi pajtueshmërinë dhe korelacionin e projekteve me politikat e Komunitetit Europian, si dhe me format e tjera të asistencave financiare;
- të gjitha informacionet të vërtetojnë që Projekti përshtatet me kriteret e përzgjedhjes në këtë dokument dhe në mënyrë të veçantë që termat ekonomike dhe përfitimet sociale afatmesme të jenë në raport me burimet e disponueshme.

3. Me qëllim sigurimin e cilësisë së lartë të projekteve, për vlerësimin e kërkesës zyrtare të projektit do të përdoren kriteret e mëposhtme seleksionuese:

- pajtueshmëria me prioritetet e përcaktuara në Marrëveshjen me Shqipërinë (natyra dhe lloji i projektit);
- fizibiliteti dhe efektshmëria ekonomike e projekteve;
- kontributi i projekteve në zbatimin e politikave të Komunitetit Europian;
- qëndrueshmëria e Projektit (qëndrueshmëria fizike e objektit dhe zbatueshmëria e Projektit);
- sigurimin e financimit (nga i njëjti Program ose programe të tjera, ose nga burime të tjera financimi) për projekte të tjera me efekte sinergjike ose plotësuese me projektin në fjalë;
- plotësimin e kushteve të nevojshme të tenderimit.

Kriteret seleksionuese të mësipërme do të detajohen më tej nga Komiteti monitorues i HiPERB-it.

4. Komiteti monitorues HiPERB-it, brenda tre muajve nga dita e marrjes së propozimeve zyrtare të projekteve, do t'i rekomandojë Ministrisë Greke të Punëve të Jashtme dhënien e ndihmës financiare në bazë të Programit, pasi është provuar se janë përmbushur kushtet e përfshira në këtë nen.

Neni 6 A

Kushtet e financimit - njohja e shpenzimeve

Do të njihen për mbështetje financiare shpenzimet e kryera që nga data e vendimit të aprovimit nga Komiteti monitorues i HiPERB-it.

Data e fundit për njohjen e shpenzimeve do të jenë 31.12.2006. Kërkesat për pagesat do të pranohen deri më 30.6.2007.

Njohja e shpenzimeve për projektet dhe aktivitetet e veçanta është përcaktuar në udhëzuesin e DAC-it.

Shpenzimet për blerjen e tokës dhe të ndërtesave ose për shpronësimet eventuale të tokës, në asnjë mënyrë, nuk do të përballohen nga fondet e Programit.

Neni 7 A
Procedurat e kontratës

Procedurat e tenderit dhe të lidhjes së kontratave për shërbimet, prokurimet dhe kontratat e projekteve të financuara nga HiPERB-i do të bëhen në përputhje me procedurat e Programit PHARE të Komunitetit European. Ftesa për tender, lidhja e kontratave dhe nënshkrimi i tyre do të bëhen nga autoritetet përgjegjëse shqiptare.

Neni 8 A
Angazhimet

Angazhimet buxhetore të HiPERB-it do të bëhen në bazë të vendimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e cila miraton planin e veprimit të Projektit, fazat e zbatimit të Projektit, grupin e projekteve, studimet dhe masat teknike mbështetëse. Angazhimet do të jenë të vlefshme për një periudhë, kohëzgjatja e së cilës varet nga natyra dhe kushtet specifike të zbatimit të veprimeve.

Neni 9 A
Pagesa

1. Pagesa e mbështetjes financiare do të bëhet në përputhje me angazhimet buxhetore të Marrëveshjes mbi Programin pesëvjeçar të bashkëpunimit për zhvillim dhe do të transferohet te koordinatori kombëtar i HiPERB-it për Shqipërinë. Pagesat mund të jenë në formën e parapagimeve, pagesave të menjëhershme ose pagimin e bilancit përfundimtar.

2. Pagesat do të bëhen si më poshtë:

a) Parapagimi mund të jetë deri në 20% të buxhetit dhe do të paguhet pas marrjes së vendimit të financimit.

b) Pagesa të ndërmjetme, që do të bëhen me kushtin që ecuria e Projektit është e kënaqshme dhe së paku 2/3 e shumës që i korrespondon pagesës së mëparshme, të jetë shpenzuar.

c) Totali i shumës të pagesave të bëra sipas pikave a dhe b nuk duhet të kalojë 80% të totalit të asistencës financiare. Për projekte të rëndësishme dhe në raste të justifikuara, përqindja mund të rritet deri në 90%.

d) Balancimi i ndihmës financiare greke do të bëhet kur të provohet se:

- Projekti ose faza e Projektit ose grupi i projekteve është realizuar në përputhje me objektivat e përcaktuara;

- Koordinatori kombëtar i HiPERB-it ka paraqitur në Komitetin monitorues të HiPERB-it një aplikim për pagesën brenda 6 muajve nga data e përfundimit fizik të Projektit ose fazës së Projektit;

- raporti final, përmendur në nenin A11>2, t'i jetë paraqitur Komitetit monitorues të HiPERB-it;

- Shqipëria i ka dërguar Komitetit monitorues të HiPERB-it një deklaratë që informacioni i dhënë në aplikimin për pagesën është i saktë.

3. Zyrtari i autorizuar i fondit special për Shqipërinë do të jetë koordinatori kombëtar i HiPERB-it, i cili do të jetë përgjegjës për certifikatat e përmendura në >2, pika b, dhe >3 pika d. Aplikimet për pagesat do të dërgohen dy herë në vit dhe do të shoqërohen me fishat standarde të monitorimit gjashtëmuajor.

4. Pagesat do t'i transferohen mbi baza gjashtëmuajore koordinatorit shqiptar të HiPERB-it, të paktën dy muaj pasi të merret një aplikim i pranueshëm për pagesën. Pagesa për çdo projekt dhe çdo përfitues në Republikën e Shqipërisë do të depozitohet në një llogari speciale, me të cilën do të bëhen pagesat e punimeve dhe ku do të depozitohen të gjitha të ardhurat (interesat).

5. Urdhri i pagesës do të shoqërohet nga një dëshmi realizimi për objektet fizike që do të lëshohet pas verifikimit në vendin e Projektit.

6. Interesat e gjeneruara nga kjo llogari do të përdoren për mbulimin e nevojave të Marrëveshjes mbi Programin pesëvjeçar të bashkëpunimit për zhvillim.

Neni 10 A
Monitorimi dhe vlerësimi

1. Koordinatori kombëtar i HiPERB-it do të jetë përgjegjësi kryesor për monitorimin e Marrëveshjes mbi programin pesëvjeçar të bashkëpunimit për zhvillim për Republikën e Shqipërisë.
2. Republika e Shqipërisë dhe Republika e Greqisë do të garantojnë që ekzekutimi i punimeve në kuadër të HiPERB-it të jetë subjekt monitorimi dhe vlerësimi.
3. Me qëllim sigurimin e efikasitetit të plotë të mbështetjes financiare, Republika e Shqipërisë dhe ajo e Greqisë do të realizojë në shqyrtim dhe vlerësim të vazhdueshëm të projekteve.
4. Gjatë zbatimit të projekteve dhe pas përfundimit të tyre, Republika e Shqipërisë dhe ajo e Greqisë do të bëjnë vlerësimin e zbatimit dhe impaktit të tyre, në mënyrë që të vlerësojnë nëse objektivat e parashikuara janë arritur apo jo. Ky vlerësim përfshin, ndërmjet të tjerave, impaktin mbi ambientin sipas rregullave të Komunitetit Europian.
5. Gjatë shqyrtimit të kërkesave të veçanta për mbështetje financiare, Republika e Greqisë duhet të mbajë parasysh rezultatet e vlerësimeve të realizuara në përputhje me parashikimet e këtij neni.
6. Monitorimi do të sigurohet nga raportet, sipas përcaktimeve të nenit A 11.
7. Koordinatori kombëtar i HiPERB-it do të dërgojë një raport mbi ecurinë e Projektit (raport vjetor) tre muaj para përfundimit të çdo viti zbatimi. Raporti përfundimtar do të paraqitet jo më vonë se 6 muaj pas datës së fundit të shpenzimeve të njohura.
8. Në bazë të rezultateve të monitorimit, si dhe marrjes në konsideratë të komenteve të Komitetit monitorues të HiPERB-it, me propozimin e Republikës së Shqipërisë, shuma dhe kushtet e ndihmës financiare, si dhe plani i financimit të ndihmës së premtuar mund të ndryshohen nga siç janë miratuar fillimisht.
9. Me qëllim rritjen e efikasitetit të HiPERB-it, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet transparencës së menaxhimit.
10. Kërkesa për asistencë e paraqitur nga Republika e Shqipërisë do të shqyrtohet nga Komiteti monitorues i HiPERB-it, për të verifikuar në mënyrë të veçantë nëse mekanizmat administrative dhe financiare janë të përshtatshme për zbatimin me efektivitet të projekteve, me qëllim që të përcaktojnë ndikimin e parashikuar në termat e objektivave të HiPERB-it, të cilat janë përcaktuar në bazë të treguesve të duhur sasiorë. Republika e Shqipërisë do të sigurojë informacionin e nevojshëm referuar në nenin 9 paragrafi 3, përfshirë edhe rezultatet e studimit të fizibilitetit dhe vlerësimet paraprake. Për të bërë këtë vlerësim, në mënyrë sa më efektive që të jetë e mundur, Republika e Shqipërisë duhet të paraqesë vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin, kur është e mundur, si dhe eventualisht mundësitë e alternativave si mundësive të koordinimit të mundshëm me projekte të tjera të interesit të përbashët dhe në të njëjtën zonë ndërhyrje.

Neni 11 A
Raportimi

Raportet që do të paraqiten në kuadër të monitorimit do të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

- a) zhvillimet e rëndësishme social-ekonomike ose modifikime në politikat kombëtare, rajonale ose sektoriale;
 - b) ecurinë e zbatimit ose prioritetet dhe masat e HiPERB-it, duke bërë një përcaktim sasior të treguesve konkretë, të impaktit dhe rezultateve të tyre;
 - c) ekzekutimin financiar të projekteve me një listë të përgjithshme të shpenzimeve të paguara nga Greqia dhe përcaktim sasior të treguesve financiarë;
 - d) masat e ndërmarra nga Komiteti Monitorues i HiPERB-it për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit;
 - e) masat e ndërmarra për të siguruar pajtueshmërinë me politikat e Komunitetit Europian.
- Raportet të cilat do të paraqiten pranë Komitetit monitorues të HiPERB-it janë si më poshtë:
1. Raportet vjetore, të dorëzuara tre muaj para përfundimit të çdo viti të plotë kalendarik të zbatimit, të cilat përfshijnë informacionin e mëposhtëm:
 - a) një përshkrim të projekteve të ndërmarra, të shoqëruara me treguesit fizikë, shpenzimet për

kategori të projekteve dhe, eventualisht, masat e marra si rezultat i kushteve specifike të përfshira në vendimin për asistencën të grantit;

b) informacion për të gjitha veprimet publicitare;

c) certifikatë e konformitetit të projektit me vendimin për asistencën financiare të dhënë;

d) një vlerësim paraprak të masës së arritjes së rezultateve të pritshme, duke përfshirë në mënyrë të veçantë:

- datën efektive të zbatimit të Projektit;

- mënyrën sipas së cilës do të menaxhohet Projekti pasi të jetë përfunduar;

- një konfirmim të parashikimeve financiare, në mënyrë të veçantë, përsa i përket kostos operative dhe të të ardhurave të pritshme;

- konfirmim të parashikimeve social-ekonomike, në mënyrë të veçantë të kostove dhe të përfitimeve të pritshme;

- paraqitjen e masave të ndërmarra për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të kostos së këtyre masave.

2. Raportet përfundimtare të paraqitura, maksimumi brenda 6 muajve pas datës së fundit të shpenzimeve të njohura të cilat përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

a) asistencën financiare të premtuar dhe të paguar nga Greqia për Shqipërinë sipas kategorive dhe projekteve të sektorëve që asistohen;

b) impakti social-ekonomik në Shqipëri i HiPERB-it, përfshirë impaktin në sektorin e punësimit;

c) një përmbledhje e informacionit që ka të bëjë me programet e zbatuara në Shqipëri;

d) kontributet e HiPERB-it ndaj përpjekjeve të Shqipërisë për zbatimin e politikave të zhvillimit në sektorët që asistohen;

e) informacion mbi masat e marra për të siguruar koordinimin dhe koherencën midis projekteve të financuara nga HiPERB-i, përpjekjet e Shqipërisë në lidhje me investimet në sektorët që asistohen, kryerjen e studimeve parapërgatitore, rezultatet e vlerësimeve, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve dhe informacionin në lidhje me ndonjë ndryshim të Projektit, përshtatshmërinë me rezultatet e parashikuara;

f) informacion i përmbledhur mbi rezultatet e kontrolleve të kryera, të parregullsive të gjetura dhe të procedimeve administrative ose gjyqësore në vazhdim.

Raporti vjetor do t'i dorëzohet Komitetit Monitorues të HiPERB-it dhe do të shqyrtohet dhe miratohet nga Komiteti i përbashkët monitorues.

Në qoftë se brenda 2 muajve mbasi është marrë raporti vjetor, Komiteti monitorues nuk dërgon deklaratat të justifikuara për pamjaftueshmërinë e raportimit, raporti do të konsiderohet i pranuar. Në rastin e raportit final kjo periudhë është 5 muaj.

Neni 12 A

Kontrolli

Shqipëria do të formojë, në kuadrin e saj legjislativ, mekanizmat e kontrollit financiar për të cilat do të informojë Greqinë, dhe do t'i japë informacion Komitetit monitorues të HiPERB-it dhe Greqisë mbi shtrirjen, planifikimin kohor dhe konkluzionet e kontrolleve për projektet e financuara nga HiPERB-i.

Komiteti monitorues i HiPERB-it ka të drejtën të ndërmarrë nëpërmjet Sekretariatit ose ekspertëve të pavarur, në bashkëpunim me mekanizmat shqiptarë të kontrollit:

- vizita monitoruese tek përfituesit përfundimtarë dhe në projektet në zbatim;

- kontrolle verifikimi në formën e auditimit financiar.

Në raste parregullsish në informacionin e dhënë nga përfituesi final, Komiteti Monitorues i HiPERB-it, nëpërmjet raporteve ose aplikimeve për pagesë, mund të vendosë të procedojë me masat korrigjuese ndaj përfituesit përfundimtar. Në rastet kur masat korrigjuese nuk zbatohen siç duhet, Komiteti monitorues, HiPERB-it mund të reduktojë, të pezullojë ose ta anulojë asistencën. Reduktimi ose anulimi eventual i asistencës financiare do të bëhet deri në masën e mbulimit të shumave të paguara. Përmasa e korrigjimit do të përcaktohet nga Pala Greke, ndërsa koordinatori kombëtar i HiPERB-it do të jetë përgjegjës për kordinimin e procedurave të balancimit ose mbulimit të shumave të paguara.

Neni 13 A
Publiciteti dhe informacioni

Shqipëria duhet të garantojë publicitet të mjaftueshëm për projektet e financuara nga HiPERB dhe në mënyrë të veçantë do të informojë:

- përfituesit përfundimtarë potencialë për mundësitë e bashkëfinancimit;
- publikun e gjerë për rolin e Greqisë në lidhje me projektet e lartpërmendura dhe rezultatet e arritura prej tyre.

Përgjegjësia për të informuar publikun e gjerë mbi projektet do të merret përsipër nga përfituesit e projekteve, të cilët do të publikojnë përmbajtjen e veprimeve dhe do të informojnë për sa më sipër median (shtypin, radion, televizionin) në mënyrën më të përshtatshme (faqeve të internetit, broshura, artikuj, njoftime shtypi etj.)

Masat informative dhe publicitare që kanë të bëjnë me opinionin publik do të përfshijnë elementet e mëposhtëm:

- vendosja e reklamimeve në sheshet e ndërtimit;
- vendosja pllakave përkujtuese të përhershme në infrastrukturën e përdorur nga publiku i gjerë.

Reklamimet dhe pllakat përkujtuese duhet të përmbajnë emblemën kombëtare të Greqisë, si dhe një tregues të pjesëmarrjes financiare të Greqisë. Në rastin e publikimeve (ftesa, komunikime etj.) pjesëmarrja e Greqisë duhet të tregohet e qartë. Komunikimet në lidhje me grantin e asistencës për përfituesit nga organet kompetente duhet të tregojnë shumë ose përqindjen e pjesëmarrjes së Greqisë. Në materialet e tjera (komunikime, buletine, materiale të printuara etj.) duhet të përfshihen një tregues i dukshëm i pjesëmarrjes së Greqisë, si dhe emblema greke.

Shqipëria do të informojë Komitetin monitorues të HiPERB-it nëpërmjet raporteve vjetore mbi iniciativat e ndërmarra për sigurimin e publicitetit të punëve të bashkëfinancuara nga HiPERB-i.

Neni A 14
Përdorimi i euros

1. Plani i financimit, kërkesa për mbështetje, deklarimi i shpenzimeve, aplikimet për pagesat dhe disbursimet duhet të shprehen në euro.

2. Pagesat e mbështetjes financiare nga Pala Greke, duhet të shprehen në euro.

3. Kursi i këmbimit që do të përdoret do të jetë ai i publikuar nga Banka Qendrore Europiane, në datën e regjistrimit të deklaratës të shpenzimeve, në dokumentet kontabël të autoriteteve kompetente për menaxhimin financiar të projektit/programit. Në rast se ky informacion nuk është i disponueshëm, kursi i këmbimit që do të përdoret do të jetë ai i publikuar nga "The Financial Times" e Londrës, ditë-punën e parë të muajit gjatë së cilit deklarata e shpenzimeve është regjistruar në dokumentet kontabël të Projektit/Programit. Në rast se edhe ky informacion nuk është i disponueshëm, kursi i këmbimit do të vendoset në marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Neni A 15
Dispozita përfundimtare

1. Kjo shtojcë do të hyjë në fuqi me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes mbi një program pesëvjeçar bashkëpunimi për zhvillim dhe mbetet në fuqi deri në pagesën e fundit të vitit të fundit të Programit.

2. Raportet siç janë përcaktuar në nenin A 11, si dhe dokumentet e shkëmbyer midis Palëve do të shkruhen në gjuhën angleze.

3. Çdo amendim ndaj kësaj shtojce do të bëhet në përputhje me nenin 10 të kësaj Marrëveshje.